



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1299
Dt 31.10.2016

Në bazë të nenit 48 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.10.2016, mori:

VENDIM

- I. Për aprovimin e raporteve të komisioneve për angazhimin e stafit akademik në procesin mësimor për vitin akademik 2016-2017, sipas konkursit të datës 9.9.2016, në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.
 - II. Kandidatët të cilët janë përzgjedhur për angazhim në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
 - III. Kontratat e punës për stafin e propozuar për angazhim, sipas raporteve të komisioneve të njësive akademike, do të përpilohen sipas dispozitave ligjore, nga organet kompetente. Nënshkrimi i kontratave për angazhim me honorar do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimin të studentëve. Kontrata do të bëhet veç e veç për secilin semestër të vitit akademik 2016/17, duke përfshirë edhe obligimet, që dalin nga procesi mësimor (mbajtja e provimeve, etj.).
 - IV. Dekanët e njësive akademike mbajnë përgjegjësi për rastet e konflikteve të interesit për kandidatët e përzgjedhur.
 - V. Këtij vendimi i bashkëngjitet njoftimi mbi kandidatët e suksesshëm nga konkursi plotësues për angazhimin e stafit akademik për vitin akademik 2016/2017.
 - VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Vendimi i dërgohet:
1. Arkivit të UMIB-it;
 2. Fakulteteve;
 3. Drejtorit të DAP;
 4. Zyrtarit për paga;
 5. Zyrës së personelit;
 6. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it